



**The British School
of Kosova**

The British School of Kosova, bazuar në Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, nr.10/2018 për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, shpall këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës/e

Dy (2) pozita në nivelin fillor;

Një (1) pozitë në nivelin fillor, klasa ndërkombëtare

Detyrat dhe përgjegjësitë për Mësimdhënës/e

Të realizoj planprogramin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;

Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;

Të përgatit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;

Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me Udhëzimet Kurikulare;

Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;

Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës, si dhe

Detyrat tjera që janë të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

Kushtet dhe Kualifikimi:

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. ***Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre Udhëzimeve Administrative, nuk do të shqyrtohen, përkatësisht refuzohen.***

Dokumentet e nevojshme:

Rezymeja Personale (CV);

Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) i fotokopjuar;

Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara tek noteri;

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT; Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Dokumentet duhet të jenë në kopje dhe ato nuk do të kthehen.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit: 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit, aplikacionet dorëzohen nga data 22/06/2021/ deri me datën 07/07/2021/ në orën 16:00 në administratën e shkollës në kopje fizike ose përmes e-mailit në: info@britishschoolofkosova.com

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.